



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 3/ Datë 30.10.2007
PËR

MIRATIMIN E FONDIT PËR REALIZIMIN E DISA INVESTIMEVE PËR
VITIN 2007

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Punëve Publike PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR REALIZIMIN E DISA INVESTIMEVE PËR VITIN 2007", bazuar në Ligjin nr. 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " neni 32, germa "dh", në ligjin nr. 8399 date 09.09.1998 " Për buxhetin lokal ", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit per vitin 2007." Udhëzimin Nr.353 date 19.03.2007 i Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2007", si dhe V.K.B. nr 2 dt 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondi prej 1.800.000 lekë për studimin: Projekt ide dhe Projekt zbatim për kthimin e Bulevard Shën Gjergji në zonë këmbësore i cili do të përballohet nga fondi i planifikuar për pajisje për vitin 2007 dhe nga zëri i shpenzimeve operative (shpenzime pritje-percjellje), i detajuar sipas tabelës së mëposhtme dhe me këtë strukturë buxhetore:

Nr	Emërtimi	Fondi i planifikuar	Ndryshimet		Fondi i ndryshuar
			-	+	
1	Instrument total	1.000.000	1.000.000		--
2	Kondicionere	150.000	150.000		--
3	Rafte druri dhe metalike	200.000	150.000		50.000
4	Fikse zjarri.sinjale alarmi	290.000	90.000		200.000
5	Radiatorë, pajisje kaldaje etj	190.000	140.000		50.000
6	Shpenzime pritje	996.000	270.000		726.000
7	Studime urbane			1.800.000	1.800.000
TOTALI		2.826.000	1.800.000	1.800.000	2.826.000

Pakësohet	00	01110 05	Art 2310000	- 1.530.000 lekë
Pakësohet	00	01110 05	Art 6020000	- 270.000 lekë
Shtohet	00	01110 05	Art 2300000	+ 1.800.000 lekë

2. Të miratojë fondin prej 3.236.894 lekë për rikonstruksionin e Drejtorisë së të Ardhurave (ish dyqani i luleve), të Zyrës së Informacionit dhe të banjove të katit të parë të Bashkisë të detajuar si më poshtë:

- Rikonstruksion i Zyrave të Drejtorisë së të Ardhurave (ish dyqani i luleve) në vlerën 2.180.645 lekë
- Rikonstruksion i Zyrës së Informacionit në vlerën 607.557 lekë
- Rikonstruksion i banjave të katit të parë në Bashki në vlerën 448.692 lekë.

Nga fondi i planifikuar për rikonstruksionin e Drejtorisë së të Ardhurave (ish dyqani i luleve), të Zyrës së Informacionit dhe të banjove të katit të parë të Bashkisë në vlerën 3.236.894 lekë, vlera prej 468.000 lekë do të mbulohet nga shpenzimet operative të Bashkisë në zërin “meremetime të ndryshme”, kurse diferenca prej 2.768.894 lekë do të planifikohet në buxhetin e vitit 2008 me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	01110 05	Art 6020000	- 468.000 lekë
Shtohet	00	01110 05	Art 2310000	+ 468.000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes, si dhe Drejtoria Punëve Publike në Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE